



Co-funded by
the European Union

Q-SURE

Newsletter


May - August, 2024



Improving University Quality Assurance Resilient Strategies Toward Excellence



QA-SURE është një projekt i Erasmus+ për ngritjen e kapaciteteve në Arsimin e Lartë që fokusohet në përshtatjen e praktikave, instrumenteve, metodologjive moderne dhe evropiane të sigurimit të cilësisë dhe në këtë mënyrë ndihmon në përafrimin e standardeve ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë.



<https://qa-sure.com/>

<https://www.umib.net/en/ior-documents/qa-sure/>



Përmbajtje

Aprovimi i Planit për Sigurimin e Cilësisë	4
Vizitë Studimore në International Social Sciences Business School (ISSBS) në Celje, Slovenia	5
Raport i vizitës studimore në Sloveni 20-21 Qershor, 2024	7
Procesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes së vlerësuesit të jashtëm	8
Ekipi UIBM i projektit QA-SURE, organizoi një takim koordinues.....	9
[18 korrik, 2024]	9
Trajnimet me stafin administrativ dhe me studentë u përfunduan me sukses- QASURE	10
QASURE – Fillon trajnimi i stafit akademik.	16
QA-SURE @UIBM	19

Aprovimi i Planit për Sigurimin e Cilësisë

Plani për sigurimin e cilësisë është hartuar nën udhëheqjen e përfaqësuesve të UIBM-së në bashkëpunim të ngushtë me bashkë-udhëheqësin e pakos së punës numër 6, UEJL.



Pas draftit të parë, PSC-ja u nda me përfaqësuesit e universiteteve partnere, të cilët ofruan komente dhe sugjerime që pasuruan dhe rafinuan përmbajtjen e PSC-së.

Anëtarët e Bordit të Sigurimit të Cilësisë, në mbledhjen online të datës 29.5.2024, miratuan PSC-në dhe Tabelën e Indikatorëve të Performancës.

<https://drive.google.com/drive/folders/11oj2dVE9IVryHV-I8UA9CK0UuyNL2mqL>



Vizitë Studimore në International Social Sciences Business School (ISSBS) në Celje, Slovenia

Si pjesë e projektit Erasmus+ Improving University Quality Assurance Resilient Strategies Toward Excellence (QA-SURE)”, më 20 qershor 2024, partnerët e projektit mbajtën një takim në Shkollën Ndërkombëtare të Biznesit të Shkencave Sociale (ISSBS) në Celje, Slloveni.

Ky projekt synon të përmirësojë praktikën e sigurimit të cilësisë brenda sektorit akademik, duke bashkuar shumë universitete nga vende të ndryshme për të bashkëpunuar dhe ndarë njohuritë dhe ekspertizën e tyre mbi këtë temë.





Gjatë Qershorit 2024, konsorciumi QA-Sure ka përfunduar vizitën studimore në Shkollën Ndërkombëtare të Biznesit të Shkencave Sociale (ISSBS) në Celje dhe Agjencinë Kombëtare të Akreditimit të Republikës së Sllovenisë (NAKVIS) në Ljublanë.

Vizita studimore i lejoj partnerët e Shqipërisë dhe Kosovës të mësojnë më shumë rreth praktikave të ISSBS dhe përvojave të tyre në ndërtimin e strukturave dhe kompetencave të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu, vizita në NAKVIS u mundësoi pjesëmarrësve të kuptojnë se si shkon procesi i akreditimit të IAL-ve në Slloveni.

Në përgjithësi, vizita studimore përfshiu prezantime dhe diskutime të ndryshme në lidhje me Menaxhimin e Cilësisë Totale, Dixhitalizimin e Sistemeve të Sigurimit të Cilësisë, Praktikat më të mira në SC dhe njohuritë dhe aftësitë e transferueshme që partnerët e Shqipërisë dhe Kosovës mund të adaptojnë.





Raport i vizitës studimore në Sloveni 20-21 Qershor, 2024

Në përputhje me WP6, ku UIBM dhe UEJL janë lider, pjesëmarrësve iu shpërnda një pyetësor vlerësues. Anketa u krye në mënyrë konfidenciale dhe në raundin fillestar të përgjigjeve, morëm të dhëna nga 13 pjesëmarrës nga të gjitha IAL-të partnere nga Kosova dhe Shqipëria. Nëpërmjet këtij anketimi ne kemi dashur të mbledhim informacion të vlefshëm kryesisht për organizimin e vizitës studimore dhe përmbajtjen e temave të diskutuara gjatë kësaj vizite studimore. Pyetësori ishte i përbërë nga 10 pyetje ku shumica prej tyre ishin pyetje të mbyllura.

REPORT

on

Evaluation of the study visit to Slovenia
“Improving University Quality Assurance Resilient Strategies Toward
Excellence” (QA-SURE)



<https://drive.google.com/drive/folders/11oj2dVE9IVryHV-I8UA9CK0UuyNL2mqL>



Procesi i rekrutimit dhe përzgjedhjes së vlerësuesit të jashtëm

Më 10 maj 2024, projekti QA-Sure ka shpallur një thirrje të hapur për një ekspert të jashtëm. Procesi i përzgjedhjes për vlerësuesin e jashtëm për Projektin QA-SURE ka përfunduar me sukses. Ky projekt, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit Erasmus+, është fokusuar në rritjen e sigurimit të cilësisë universitare përmes strategjive fleksibile për përsosmëri.



Procesi i përzgjedhjes ishte shumë konkurrues, duke përfshirë disa kandidatë të dalluar. Pas një rishikimi të plotë bazuar në një shkallë vlerësimi të detajuar dhe kriteret specifike, kandidati i përzgjedhur është zgjedhur bazuar në kualifikimet dhe përvojën e tij të jashtëzakonshme.

https://www.linkedin.com/posts/qa-sure-improving-university-quality-assurance-resilient-strategies-toward-excellence-evaluation-decision-activity-7222321484474535936-EM9N?utm_source=share&utm_medium=member_desktop



Ekipi UIBM i projektit QA-SURE, organizoi një takim koordinues [18 korrik, 2024]

Ekipi i projektit QA\SURE UIBM mbajti takimin e radhës koordinues, i cili u fokusua në diskutimin e aktiviteteve të deritanishme, si dhe planifikimin për aktivitetet e ardhshme. Raporti për vizitën studimore në Slloveni nga përfaqësuesit e UIBM-së si dhe aktivitetet tjera të parapara si procesi i vazhdueshëm i aktiviteteve të projektit, përgatitjet për trajnimet që do të marrin pjesë në UIBM, si dhe procesi i blerjes së pajisjeve ishin temat kryesore të rendin e ditës. Projekti QA\SURE synon të përmirësojë praktikat e sigurimit të cilësisë brenda sektorit akademik, duke bashkuar shumë universitete nga vende të ndryshme për të bashkëpunuar dhe ndarë njohuritë dhe ekspertizën e tyre mbi këtë temë.





Trajnimet me stafin administrativ dhe me studentë u përfunduan me sukses- QASURE

Si pjesë e projektit të Erasmus+ 'Improving University Quality Assurance Resilient Strategies Toward Excellence (QA-SURE)', partnerët e projektit u takuan në Mitrovicë, Kosovë.

Trajnimi për stafin administrativ dhe studentët u mbajt më 26 dhe 27 Gusht në Kolegjin Ndërkombëtar



të Biznesit Publik (IBCM) në Mitrovicë dhe Universitetin "Isa Boletini" Mitrovicë. Trajnimi ka të bëjë me praktikën e BE-së për Sigurimin e Cilësisë në arsimin e lartë.

Është përfunduar me sukses trajnimi dy-ditor në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve si pjesë e projektit Erasmus+ 'Improving University Quality Assurance Resilient Strategies Toward Excellence (QA-SURE)'.



Trajnimi i dedikuar administratës, studentëve aktualë dhe studentëve Alumni, nën udhëheqjen e trajnerëve nga Shkolla Ndërkombëtare e Biznesit për Shkenca Sociale (ISSBS) - Silloveni dhe Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) - Maqedoni e Veriut, u karakterizua nga diskutime interaktive për rëndësinë e përmirësimit të cilësisë në arsimin e lartë, mbi rolin e secilës palë të interesit në këtë proces ciklik si dhe në shkëmbimin e përvojave pozitive.







Në vazhdim të trajnimit në kuadër të projektit QA SURE nga projekti Erasmus+ "Improving University Quality Assurance Resilient Strategies Toward Excellence", u mbajt sesiioni i radhës me studentët. Pjesëmarrja e tyre tregoi përkushtimin dhe përgjegjësinë e tyre në përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë. Standardet e ESG, roli i studentëve, praktikat e mira dhe prezantimi i përvojave të studentëve ishin në fokus të këtij sesiioni.



<https://www.umib.net/en/qa-sure-training-with-the-students/>



Pjesëmarrja e studentëve tregoi përkushtimin dhe përgjegjësinë e tyre në përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë. Standardet e ESG, roli i studentëve, praktikat e mira dhe prezantimi i përvojave të studentëve ishin në fokus të këtij sesi.





Në fund trajnimi u mbyll me një vizitë në Muzeun e Mineraleve në qytetin e Mitrovicës.



<https://www.umib.net/en/the-training-within-gasure-was-successfully-completed/>





QASURE – Fillon trajnimi i stafit akademik.

Në kuadër të projektit të Erasmus+ ‘Improving University Quality Assurance Resilient Strategies Toward Excellence (QA-SURE),’ partnerët e projektit janë mbledhur në Tiranë, Shqipëri. Trajnimi për stafin akademik është mbajtur në Universitetin Polis në datat 29-30 gusht 2024. Këto aktivitete synojnë të nxisin një dialog produktiv midis strukturave të menaxhimit të cilësisë dhe personelit akademik, me synim përfundimin e ciklit të sigurimit të cilësisë dhe ngritjen e kapaciteteve të nevojshme si dhe vendosjen e bazave për sisteme të fuqishme të sigurimit të cilësisë.

Përfaqësues të UIBM si pjesëmarrës në këtë trajnim ishin: koordinatorja e projektit QASURE, Prof. Merita Shala, Prorektori për Zhvillim Akademik dhe Cilësi, Prof. Sabri Avdullahi, si dhe nga radhët e stafit akademik dhe në të njëjtën kohë Prodekanja për Mësim dhe Zhvillim të Cilësisë në Fakultetin Ekonomik, Prof. Filloreta Kunoviku Demiri.

Projekti QA-SURE fokusohet në integrimin e praktikave, instrumenteve dhe metodologjive moderne evropiane të sigurimit të cilësisë për të ndihmuar në harmonizimin e standardeve të sigurimit të cilësisë së partnerëve të projektit me ato të përshkruara në ESG-të 2015 dhe praktikat e tjera më të mira evropiane.





<https://www.umib.net/en/qasure-academic-staff-training-starts/>



QA-SURE @UIBM

www.qasure.net

<https://www.facebook.com/profile.php?id=61556527588234>

<https://www.linkedin.com/company/qa-sure-improving-university-quality-assurance-resilient-strategies-toward-excellence/>



University “Isa Boletini” - Mitrovica
Str. Ukshin Kovacica, 40000 Mitrovica
Republic of Kosovo

www.umib.net

E-mail: info@umib.net

<https://www.umib.net/en/ior-documents/qa-sure/>